

## NË EMËR TË POPULLIT

### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

**Lënda: PKR 1098/13**

**Data: 18 nëntor 2015**

Gjykata Themelore në Prishtinë në trupin gjykues të përberë nga kryetari i trupit gjykues Vladimir Mikula dhe anëtarët e trupit gjykues Anita Krasniqi-Prenaj dhe gjyqtari Piotr Bojarczuk, të ndihmuar nga procesmbajtësja Dea Dedi, në çështjen penale kundër:

**G. K**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**S. S**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**N. D**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**S. A**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**N. Z**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në rrugën (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**J. R**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në fshatin (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**N. Sh**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**Xh. H**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**V. K**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në rrugën (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**Z. S**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në fshatin (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**I. R**, mashkull, i lindur në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në fshatin (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

**Të gjithë këta të akuzuar** sipas aktakuzës së datës 11.12.2013 dhe të ngritur në Gjykatën Themelore në Prishtinë më 12.12.2013 për veprat penale siç përshkruhen në aktakuzë, si në vijim:

**G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R** të gjithë prej tyre të akuzuar me;

**PIKA 1: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, i lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës (më tej në tekst ‘KPK’), vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**PIKA 2: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1, i lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**PIKA 3: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet;

**PIKA 4: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

**G. K, N. D dhe S. A** të akuzuar për:

**PIKA 5: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**S. A** i akuzuar për:

**PIKA 6: Kanosja**, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej një (1)deri në pesë (5) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 7: Kanosja**, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej një (1)deri në pesë (5) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 8: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 9: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 10: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

**S. S, N. Z, N. Sh dhe Xh. H** të gjithë prej tyre të akuzuar për:

**PIKA 11: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**V. K, Z. S, J. R dhe I. R** të gjithë prej tyre të akuzuar për:

**PIKA 12: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 13: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**G. K** i akuzuar për:

**PIKA 14: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

**S. S** i akuzuar për:

**PIKA 15: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**S. S** i akuzuar për:

**PIKA 16: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

**G. K** dhe **N. D** të dy të akuzuar për:

**PIKA 17: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike**, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, i lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet;

**G. K** dhe **N. D** të dy të akuzuar për:

**PIKA 18: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet;

**G. K** dhe **N. D** të dy të akuzuar për:

**PIKA 19: Sulmi**, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur paragrafin 1 dhe me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet;

Pas mbajtjes se seancave gjyqësore në prani të prokurorit të EULEX-it, Danilo Ceccarelli, të akuzuarit dhe avokatet e tyre mbrojtës Aziz Rexha për G. K, Nexhat Shabani për S. S, Bajram Maraj për N. D, Rame Dreshaj për S. A, Gani Asllani për N. Z, Naser Sopjani për J. R, Xhafer

Maliqi për Xh. H, Teuta Zhinipotoku për V. K, Merita Stublla-Emini për Z. S, Albana Kelmendi për I. R, Fatmire Braha për N. Sh

Në datat e mëposhtme:

8 dhe 17 korrik 2014;  
10, 11, 24 dhe 25 shtator 2014;  
8, 9, 22, 23 dhe 24 tetor 2014;  
19 nëntor 2014;  
3, 9, 10, 11 dhe 16 dhjetor 2014;  
15, 27, 28 dhe 29 janar 2015;  
3, 4 dhe 5 shkurt 2015;  
3, 9 dhe 12 mars 2015;  
15, 16 dhe 17 prill 2015;  
12, 14, 18 dhe 20 maj 2015;  
30 qershor 2015;  
7 dhe 14 korrik 2015;  
25 dhe 26 gusht 2015;  
8 shtator 2015;  
9, 10 dhe 11 nëntor 2015

pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 12 nëntor 2015,

**NË PAJTIM** me nenet 359, 361, 362, 364, 365 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (më tej në tekst “KPPRK”), më datën 18 nëntor 2015, trupi gjykues në seancë të hapur dhe në prani të të pandehurve, të avokatëve mbrojtës dhe të prokurorit nxjerr këtë:

### **AKTGJYKIM**

**G. K**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

është fajtor

Sepse

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), më 8 janar 2013 në Prishtinë, Kosovë, gjersa:

- 1) E shoqëronte M. J, i cili ishte në kujdestarinë e tij dhe i cili ishte i prangosur, nga zona e recepcionit e deri te vetura, i ka dhënë shuplaka dhe e ka goditur M. J, në veturën Toyota 293-01 deri sa vetura ishte e palëvizshme (Pikat 1, 2, 3);
- 2) E shoqëronte I. P i cili ishte në kujdestarinë e tij dhe i cili ishte i prangosur, nga zona e recepcionit deri te vetura, e ka keqtrajtuar atë duke e goditur me duart e tij brenda furgonit Mercedes 288-01 (Pikat 1, 2, 3);
- 3) E shoqëronte B. M, i cili ishte i prangosur në veturën Mercedes 413-01, nga qendra e paraburgimit në Prishtinë për në Gjykatën për Kundërvajtje, duke qenë shumë agresiv ndaj B. M, e godiste dhe e shqelmonte më çizmet e tij luftarake në stomak dhe në shpinë, e sidomos kur ai refuzonte të konfirmojë se ai jeton në Kosovën e pavarur. Ai ia drejtoi pistoletën në kokën e tij gjersa S. A ia drejtoi pistoletën e tij në gjunjët e B. M më qëllim që ta detyronte atë të thoshte“... Kosova është republikë”. **G. K** e goditi B. M me kondakun e pushkës se tij në kraharor dhe kjo bëri që B. M të luftonte për ajër dhe **G. K** e rrahu atë në këtë mënyrë rrugës nga qendra e paraburgimit në Prishtinë deri në Gjykatën për Kundërvajtje (Pikat 5, 7, 8, 9, 13);
- 4) Së bashku me **N. D**, ai e shqelmoi D. V me çizmet e tij luftarake në stomak dhe në ijë dhe në gjenitale dhe verbalisht e ka fyer dhe e ka sulmuar atë në tualetin e Gjykatës për Kundërvajtje. (Pikat 17, 18,).

Prandaj ai ka kryer;

- Me veprimet në pikat 1, 2, 3 dhe 4 më lart, katër vepra penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, gjersa veprat penale nën 3 dhe 4, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së;
- Me veprimet në pikat 1 dhe 2 më lart, dy veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së;
- Me veprimet në pikat 3 dhe 4 më lart, dy veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së;
- Me veprimin në pikën 3 më lart, një vepër penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4, në bashkëkryerje dhe në pajtim me nenin 31 të KPK-së;

Prandaj, trupi gjykues shqipton dënimet si më poshtë:

Për veprën penale nën 1 të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 8 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 2 të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 8 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të

KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 3 të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 4 të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dënim me burgim prej 8 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 1 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74 dhe 187, paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 6 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 2 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së, në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74 dhe 187, paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 6 muajsh. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 3 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dhe në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74 dhe 187, paragrafi 2 të KPK-së, dënim me burgim prej një (1) viti. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 4 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dhe në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74 dhe 187, paragrafi 2 të KPK-së, dënim me burgim prej një (1) viti. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Për veprën penale nën 3 të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dhe në pajtim me nenet 41, 45, 73, 74 dhe 185, paragrafi 4 të KPK-së, dënim me burgim prej një (1) viti. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 1 vit.

Në pajtim me nenin 80 të KPK-së, gjykata shqipton një dënim unik me burgim prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj.

Në pajtim me nenin 65, paragrafi 1 të KPK-së, dënim me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite.

**S. S**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), dhe udhëheqës i ekipit, më 8 janar 2013 në Prishtinë, Kosovë, gjersa:

- 1) E shoqëronte B. M, i cili ishte në kujdestarinë e tij dhe i cili ishte i prangosur, nga zona e recepcionit e deri te vetura, e ka shqelmuar dy herë më çizmet luftarake dhe e ka goditur B. M gjersa sa ishte duke dalë nga vetura dhe gjersa ishte në veturën Mercedes 413-01, ia kishte lidhur rripin e ulëses rreth qafës B. M dhe kishte vazhduar ta rrihte atë, (Pikat 1, 2, 3, 15);
- 2) E shoqëronte I. P, i cili ishte në kujdestarinë e tij dhe i cili ishte i prangosur, nga zona e recepcionit e deri te vetura ia ka dhënë I. P një ‘shuplakë mbrapsht’ (Pikat 1, 2, 3);

Prandaj ai ka kryer:

- Me veprimet nën 1 dhe 2, dy veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1 të KPK-së;
- Me veprimet nën 1, veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2 të KPK-së
- Me veprimet nën 2, dy vepra penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së

Prandaj, trupi gjykues shqipton dënimet e mëposhtme:

Për veprën penale nën 1 të Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 1 viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim me nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së, për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik dy (2) vite;

Për veprën penale nën 2 të Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74,



dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej 1 viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim më nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së, për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite;

Për veprën penale nën 1 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2 të KPK-së. Në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74, dhe 187 paragrafi 2 të KPK-së, dënim me burgim prej 1 viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim me nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së, për kohën e verifikimit prej dy (2) vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Për veprën penale nën 2 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1 të KPK-së. Në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74, dhe 187 paragrafi 1 të KPK-së, dënim me burgim prej tetë (8) muajsh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim më nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së, për kohën e verifikimit prej dy (2) vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite.

Në pajtim me nenin 80 të KPK-së, gjykata shqipton një dënim unik më burgim prej dy (2) vitesh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim më nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 3 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 3 vite;

**S. A**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), më 8 janar 2013 në Prishtinë, Kosovë:

- 1) Në veturën Mercedes 413-01 gjersa e shoqëronte **B. M**, i cili ishte i prangosur nga qendra e paraburgimit në Prishtinë deri në Gjykatën për Kundërvajtje, pasi **B. M** ka refuzuar t'i thotë **G. K** se ai jeton në Kosovën e pavarur dhe duke marrë nga **G. K** një numër të konsiderueshëm të goditjeve, **S. A** si shofer i veturës Mercedes 413-01 e ndali veturën dhe e mbushi armën e tij dhe ia drejtoi në gju të **B. M** dhe po ashtu e rrahu **B. M** në veturën policore Mercedes 413-01 (Pikat 5, 6)

Prandaj ai ka kryer:

- Veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së;
- Veprën penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 31 të KPK-së;

Prandaj, trupi gjykues shqipton dënimet e mëposhtme:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së dhe në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74, dhe 198 paragrafi 4 të KPK-së, dënim me burgim prej 1 viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim me nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjate periudhës së verifikimit. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Për veprën penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185, paragrafi 4 i lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së, dhe në pajtim me nenet 41, 49, 50, 52, 73, 74, dhe 185 paragrafi 4 të KPK-së, dënim me burgim prej 1 vit, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim me nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Në pajtim me nenin 58, paragrafi 2 dhe 59 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 të KPK-së, gjykata e urdhëron **S. A** që të përmbahet nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve për periudhën kohore të verifikimit. Nëse i pandehuri nuk vepron në përputhje me këto kushte, gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht në pajtim me nenin 55 të KPK-së.

Në bazë të nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Në pajtim me nenin 80 gjykata shqipton dënimin unik me burgim prej një (1) viti e gjashtë (6) muajve, ekzekutimi i të cilit pezullohet në pajtim me nenin 51, paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjate kohës së verifikimit. Në pajtim me nenet 58, paragrafi 2 dhe 59 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 të KPK-së, gjykata e urdhëron **S. An** që të përmbahet nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve për periudhën kohore të verifikimit. Nëse i pandehuri nuk vepron në përputhje me këto kushte, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht në pajtim me nenin 55 të KPK-së. Në pajtim me nenin 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite.

**N. D**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, derisa:

- 1) E shoqëronte **B. M** i cili ishte i prangosur, nga qendra e paraburgimit e Prishtinës për në Gjykatën për Kundërvajtje, e goditi **B. M** në ndërtesën e gjykatës (PIKA 5).
- 2) Bashkë me **G. K** ai e shqelmoi me çizme luftarake **D. V** në stomak, ijë dhe gjenitale dhe e ka fyer verbalisht dhe e ka sulmuar në tualetin e gjykatës. (Pikat 17, 18).

Prandaj me këto veprime ka kryer:

Me veprimet nën 1 dhe 2 i ka kryer dy vepra penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPK-së;

Me veprimet nën 1 ka kryer veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së;

Me veprimet nën 2 ka kryer veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 2, në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të KPK-së.

Prandaj, trupi gjykues i shqipton dënimet si më poshtë:

Për veprën penale nën 1, Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 dhe sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 i KPK dënohet me 1 vit burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik një (1) vit.

Për veprën penale nën 2, Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 dhe sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së dënim me burgim prej 1 viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Për veprën penale nën 1 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së, sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 187 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me 1 vit burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 i KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Për veprën penale nën 2 të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 2, në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPK sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 187 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me 1 vit burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Në bazë të nenit 80 gjykata e shqipton dënimin unik prej 2 vitesh burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për tre (3) vite.

**N. Z**, mashkull, i lindur më (.....) në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në rrugën (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO).

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, derisa e shoqëronte I. P i cili ishte i prangosur, nga qendra e paraburgimit e Prishtinës për në Gjykatën për Kundërvajtje, e ka keqtrajtuar I. P në furgon derisa vetura Mercedes 288-01 nuk ishte në lëvizje (Pikat 1, 2 dhe 11).

Prandaj ai ka kryer:

- Veprën penale Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 të KPK-së;
- Veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së.

Prandaj, trupi gjykues i shqipton dënimet si më poshtë:

Për veprën penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 të KPK-së dhe sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së dënohet me 6 muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51

paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Për veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së, sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 187 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me 8 muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK për kohën e verifikimit prej dy (2) vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Në pajtim me nenin 80 të KPK-së gjykata i shqipton dënimin unik prej 1 viti burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite.

**I. R**, mashkull, i lindur në (.....), emri i babait (.....), shqiptar Kosovar, më shtetësi të Kosovës, më adrese banimi aktuale në fshatin (.....), zyrtar policor më numër të kartelës identifikuese (.....);

Duke shërbyer si polic kujdestar i Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO).

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, kur B. M i cili ishte i prangosur, shoqërohej nga qendra e paraburgimit e Prishtinës për në Gjykatën për Kundërvajtje, e ka goditur në qafë B. M në furgonin Mercedes me targë numër 413-01 (Pikat 1 dhe 2).

Prandaj ai ka kryer:

- Veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 paragrafin 1 të KPK-së.
- Veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së.

Prandaj, trupi gjykues i shqipton dënimet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1 të KPK-së dhe sipas neneve 41, 49, 50, 52 73, 74, dhe 198 paragrafi 1 të KPK-së, dënohet me 6 muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51

paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 2 vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Për veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1 të KPK-së sipas neneve 41, 49, 50, 52, 73, 74 të KPK-së, dënohet me 6 muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej 1 viti, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit. Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për një (1) vit.

Në pajtim me nenin 80 gjykata e shqipton dënimin unik prej 1 viti burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 paragrafi 2 të KPK-së për kohën e verifikimit prej dy (2) vitesh, nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit.

Sipas nenit 65 paragrafi 2 të KPK-së, dënohet me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për dy (2) vite.

### **LIROHEN NGA AKUZAT**

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), **G. K**

lirohet

nga pikat e aktakuzës:

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personave të cënueshëm, përkatësisht ndaj një apo më shumë të ndaluarve të prangosur B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), gjersa i shoqëronin dhjetë të arrestuarit nga dhoma e

pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 10: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3 të KPK-së, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 15:10 deri në orën 15:30: **G. K**, zyrtar policor i Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, e ka kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personit të cënueshëm B. M, duke e goditur dhe shqelmuar të ndaluarin e prangosur derisa ishte nën kujdestarinë e të pandehurit, derisa e transportonte me veturën e policisë “Mercedes” me targa Police 413-01 nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë deri në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë.

**PIKA 14: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3 të KPK-së lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 15:30 dhe 18:00: **G. K**, zyrtar policor i Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, e ka kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personit të cënueshëm B. M, i cili ishte nën kujdestarinë e të pandehurit, duke e goditur dhe shqelmuar atë (edhe me gjësende) derisa e çonte të ndaluarin nga vetura “Mercedes” me targë Police 413-01 për në katin e parë të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë, dhe derisa ishte duke ndenjur brenda ndërtesës së gjykatës, në katin e parë, në korridor, me kokën e shtyrë për tokë.

**PIKA 19: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3 të KPK-së lidhur me paragrafin 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 15:30 deri në orën 18:00: **G. K** dhe **N. D**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personit të cënueshëm D. V, duke e shqelmuar të ndaluarin në pjesën e ijëve, gjatë shoqërimit të tij për në tualet në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **S. S**,

lirohet nga pikat e aktakuzës:

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 14:15 deri në 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personave të cenueshëm, përkatësisht ndaj një apo më shumë të ndaluarve të prangosur B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilit ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit nga dhoma e pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 11: Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 15:10 deri në 15:30: **S. S, N. Z, N. Sh dhe Xh. H**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke iu fyer rëndë dinjitetin një apo më shumë personave në vijim: I. P, M. P, D. S dhe/ose I. S, gjersa e kryenin detyrën zyrtare të transportimit të të ndaluarve me veturën e policisë “Mercedes” me targa Police 288-01 nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë deri në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë, mes tjerash, duke i goditur dhe shqelmuar viktimat (edhe me gjësende) dhe duke e futur plumbin në tytë të armëve të tyre dhe duke lëshuar muzikë shqip dhe duke kërkuar që viktimat të deklaronin se ata jetojnë në Kosovën e Pavarur/Republikën e Kosovës.

**PIKA 16: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, ndërmjet rreth orës 15:30 deri në orën 18:00: **S. S**, zyrtar policor i policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, e ka kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personit të cenueshëm, përkatësisht të ndaluarit e prangosur B. M, i cili ka qenë nën kujdestarinë e të pandehurit, duke e goditur dhe e shqelmuar atë (edhe me gjësende) derisa e çonte nga vetura “Mercedes” me targë Police 413-01 për në katin e parë të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë, dhe derisa ishte duke ndenjur brenda në ndërtesën e gjykatës, në katin e parë, në korridor, me kokën e shtyrë për tokë.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **S. A**,



lirohet

nga pikat e mëposhtme të aktakuzës:

**PIKA 1: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke iu fyer rëndë dinjitetin e një apo më shumë personave në vijim: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjersa i kryenin detyrat zyrtare, mes tjerash, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende) të cilët nuk kishin mundësi të vetëmbroheshin; duke i shoqëruar në mënyrë fyese, përkatësisht të prangosur me duar prapa me pranga plastike të shtrënguara shumë, me kokën e përkulur pa nevojë deri në tokë; janë sulmuar dhe trajtuar në mënyrë të ashpër para dëshmitarëve; janë fyer verbalisht në baza të përkatësisë etnike dhe i kanë frikësuar, derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit të cilët ishin nën kujdestarinë policëve të Njesisë Speciale Operative, nga dhoma e pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 2: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, ndërmjet rreth orës 14:15 deri në orën 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personave të cënueshëm, përkatësisht ndaj një apo më shumë të ndaluarve të prangosur B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit të cilët ishin nën kujdestarinë të policëve të Njesisë Speciale Operative, nga dhoma e pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 3: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, dhe vepër e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (5) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, ndërmjet rreth orës 14:15 deri në orën 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim, me gjësende që mund të shkaktojnë lëndime të rënda trupore apo dëmtim serioz ndaj shëndetit, përkatësisht me çizme, llambë elektrike (bateri) dore, rripa sigurimit (të veturës) dhe/ose me armë zjarri, ndaj njërit apo më shumë personave në vijim, përkatësisht ndaj një apo më shumë të ndaluarve të prangosur B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të Njesisë Speciale Operative, nga dhoma e pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187 paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, rreth orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, nga Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj personave të cënueshëm, përkatësisht ndaj një apo më shumë të ndaluarve të prangosur B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit nga dhoma e pranimit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë deri te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota” me targë nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **N. D**,

lirohet

nga pikat e mëposhtme të aktakuzës:

**PIKA 1: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, ndërmjet rreth orës 14:15 deri në orën 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke e fyer rëndë dinjitetin e një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, duke, mes tjerash, goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), të cilët nuk kishin asnjë mundësi për të mbrojtur vetveten; duke i shoqëruar ata në mënyrë fyese, përkatësisht të prangosur me duar prapa me pranga plastike të shtrënguara shumë, me kokën e përkulur pa nevojë deri në tokë; janë sulmuar dhe trajtuar në mënyrë të ashpër para dëshmitarëve; janë fyer verbalisht në baza të përkatësisë etnike dhe i kanë frikësuar, derisa i kanë shoqëruar dhjetë të ndaluarit të cilët ishin nën kujdestarinë policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 2: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, ndërmjet rreth orës 14:15 deri në 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën pa miratim ndaj një apo më shumë personave si më poshtë: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), ndërsa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e zyrtarëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 3: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të

Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën, pa miratim, me objekte që mundësojnë shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor apo dëmtim serioz për shëndetin, përkatësisht çizme, shkopinj, llamba elektrike dore, rripa të sigurisë dhe/ose armë të zjarrit, ndaj një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R,** zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën ndaj personave të cënueshëm, pa miratim, përkatësisht ndaj njërit ose ndaj më shumë të ndaluarve të prangosur si në vijim: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), ndërsa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 19: Sulm, në shkelje të nenit 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësisht midis orës 15:30 dhe rreth orës 18:00: **G. K dhe N. D,** zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkëkryerës, kryen veprën penale të Sulmit, duke ushtruar qëllimisht forcë pa miratim ndaj personit të cënueshëm D. V, duke e shqelmuar të ndaluarin në zonën ijëve, gjersa e shoqëronin për në tualet në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), **N. Z**

lirohet

nga PIKA e mëposhtme e aktakuzës:

**PIKA 3: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën, pa miratim, me objekte që mundësojnë shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor apo dëmtim serioz për shëndetin, përkatësisht çizme, shkopinj, llamba elektrike dore, rripa të sigurisë dhe/ose armë të zjarrit, ndaj një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën ndaj personave të cënueshëm, pa miratim, përkatësisht ndaj njërit ose ndaj më shumë të ndaluarve të prangosur si në vijim: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), ndërsa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **I. R**

lirohet

nga pikat e mëposhtme të aktakuzës:

**PIKA 3: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën, pa miratim, me objekte që mundësojnë shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë për shëndetin, përkatësisht çizme, shkopinj, llamba elektrike dore, rripa të sigurisë dhe/ose armë të zjarrit, ndaj një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 4: Sulm, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit qëllimisht duke e përdorur forcën ndaj personave të cënueshëm, pa miratim, përkatësisht ndaj njërit ose ndaj më shumë të ndaluarve të prangosur si në vijim: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), ndërsa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 12: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 15:10 deri në përafërsisht 15: 30 **V. K, Z. S, J. R dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke e fyer rëndë dinjitetin e M. J, gjersa e transportonin të ndaluarin me veturën e policisë “Toyota”, me targa nr. Police 293-01 nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë,

duke e goditur dhe shqelmuar personin e prangosur dhe duke e fyer verbalisht mbi baza të përkatësisë etnike.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), **J. R, N. Sh, Xh. H, V. K dhe Z. S,**

lirohen

nga pikat e mëposhtme të aktakuzës:

**PIKA 1: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësohet midis orës 14:15 dhe orës 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R,** zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke e fyer rëndë dinjitetin e një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, duke, mes tjerash, goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), të cilët nuk kishin asnjë mundësi për të mbrojtur vetveten; duke i shoqëruar ata në mënyrë fyese, domethënë me duart në pranga nga prapa me pranga shumë të ngushta plastike, me kokat të ulura deri në tokë pa pasur nevojë; duke i sulmuar dhe trajtuar ashpër në prani të dëshmitarëve; duke i fyer verbalisht mbi baza të përkatësisë etnike dhe duke i frikësuar, ndërsa i shoqëronin dhjetë të burgosurit, të cilët ishin nën përkujdesjen e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë të tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 2: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësohet midis orës 14:15 dhe orës 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R,** zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke përdorur forcën, pa miratim, ndaj një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e

Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 3: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe orës 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën, pa miratim, me objekte që mundësojnë shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor apo dëmtim serioz për shëndetin, përkatësisht çizme, shkopinj, llamba elektrike dore, rripa të sigurisë dhe/ose armë të zjarrit, ndaj një ose më shumë personave të mëposhtëm: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, të cilët ishin nën kujdestarinë e policëve të NJSO-së, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

**PIKA 4: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përafërsisht midis orës 14:15 dhe orës 15:10: **G. K, S. S, N. D, S. A, N. Z, J. R, N. Sh, Xh. H, V. K, Z. S dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Sulmit, qëllimisht duke e përdorur forcën ndaj personave të ndjeshëm, pa miratim, përkatësisht ndaj njërit ose ndaj më shumë të ndaluarve të prangosur si në vijim: B. M, I. P, M. J, D. T, I. S, B. M, D. S, D. V, M. P dhe/ose Z. M, të cilët ishin nën kujdestarinë e të pandehurve, duke i goditur dhe shqelmuar personat e prangosur (edhe me gjësende), gjersa i shoqëronin dhjetë të ndaluarit, nga dhoma e pritjes në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë te tri veturat e parkuara në parking, “Toyota”, me targa të regjistrimit nr. Police 293-01 dhe dy furgonë “Mercedes” me targa të regjistrimit nr. Police 288-01 dhe Police 413-01 edhe gjatë kohës kur veturat qëndronin të parkuara në vendparkim.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **N. Sh dhe Xh. H**,



lirohen

nga pikat e mëposhtme e aktakuzës:

**PIKA 11: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësohet midis orës 15:10 dhe orës 15:30: **S. S, N. Z, N. Sh dhe Xh. H**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke e fyer rëndë dinjitetin e një ose më shumë personave të mëposhtëm: I. P, M. P, D. S dhe/ose I. S, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, duke i transportuar të ndaluarit me veturën e policisë Mercedes me targa nr. Police 288-01 nga Qendra e Paraburgimit të Prishtinës në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë, mes tjerash, duke i goditur dhe shqelmuar viktimat (edhe me gjësende) dhe duke ngritur çarkun e armëve dhe duke lëshuar muzikë shqip gjersa kërkonin nga viktimat që të deklaronin se ata jetojnë në Kosovën e Pavarur/Republikën e Kosovës.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) **J. R, V. K dhe Z. S**,

lirohen

nga pikat e mëposhtme e aktakuzës:

**PIKA 12: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së, vepër kjo e dënueshme me burgim deri në tri (3) vjet:**

Më 08 janar 2013, në Prishtinë, Kosovë, përfaqësohet midis orës 15:10 dhe përfaqësohet orës 15:30: **V. K, Z. S, J. R dhe I. R**, zyrtarë policorë nga Policia e Kosovës, Njësia Speciale Operative (NJSO), Ekipi 3, si bashkë-kryerës, kanë kryer veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, duke i keqtrajtuar, frikësuar dhe duke e fyer rëndë dinjitetin e M. J, gjersa e transportonin të ndaluarin me veturën e policisë "Toyota", me targa nr. Police 293-01 nga Qendra e Paraburgimit në Prishtinë në Gjykatën për Kundërvajtje në Prishtinë, duke e goditur dhe shqelmuar personin e prangosur dhe duke e fyer verbalisht në baza etnike.

Asnjëra nga palët e dëmtuara nuk ka paraqitur kërkesë për kompensim të dëmit.

Të pandehurit, të cilët janë dënuar, G. K, S. S, S. A, N. D, N. Z, I. R, janë të detyruar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 300 eurosh për secilin të pandehur.

Të pandehurit, të cilët janë liruar nga akuzat, nuk janë të detyruar të paguajnë asnjë shpenzim.

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**  
**Datë 18 nëntor 2015; Lënda: PKR 1098/13**

---

Kryetar i trupit gjykues  
Vladimir Mikula

---

Proces-mbajtës  
Dea Dedi

**Mjet juridik:**

Personat e autorizuar mund t'i paraqesin Gjykatës së Apelit ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, në pajtim me nenin 380 paragrafi 1 i KPP- së.